

BERZH - Dokument Permbledhes i Projektit (DPP)

Rehabilitimi i rruges Kijeve-Peje (Zahaq)

Shteti:	Kosove
Nr. i Projektit:	46874
Spektori i biznesit:	Transport
Lloji i njoftimit:	Publik
Kategoria Mjedisore:	A
Data e parashikuar e paraqitjes ne Bord:	20 Korrik 2016
Faza e tanishme:	Ka kaluar Structure Review, ne pritje te Final Review
Data e publikimit te DPP ne Anglisht:	11 Shkurt 2016

Pershkrimi i Projektit

Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) eshte duke shqyrtuar dhenien e nje kredie sovrane per Kosoven per financimin e rehabilitimit dhe modernizimit te nje seksioni rrugor me dy korsi te dyfishta dhe gjatesi perafersisht 32 km midis Kijeves dhe Zahaqit ne afersi te qytetit te Pejes ("Projekti").

Objektivat e Projektit

Projekti eshte pjese e Route 6b te rretit rrugor te South-East Europe Transport Observatory (SEETO) qe kalon nga Peja deri ne Prishtine. Kjo rruge lidhet nepermjet Prishtines me Korridorin VIII ne IRJ te Maqedonise ne jug dhe me Korridorin X ne Serbi nepermjet Route 7 ne veri. Projekti do te lehtesoje lidhjen me qytetin e Pejes qe eshte qendra administrative dhe ekonomike e rajonit perendimor te Kosoves.

Transition Impact

Projekti do te perfshije masa qe lidhen me reforma ne sektorin rrugor dhe rritjen e kapaciteve institucionale ne fushat e meposhtme:

1. Pergatitja e nje studimi per financimin e sektorit rrugor per te percaktuar nivele te kenaqshme dhe te mundshme fondesh per sektorin rrugor si dhe burimet e te ardhurave nga te cilat ato do te merren;
2. Pergatitja dhe zbatimi i nje reforme dhe plani ristrukturues te miratuar qe do te perfshije shnderrimin e Drejtorise se Rrugeve ne nje agjenci rruges me pergjegjesi te percaktuara;

3. Krijimi i perveses kombetare ne fushen e sigurise rrugore per te siguruar qe auditimet e sigurise rrugore te perfshihen si perberese e rregullt e te gjitha projekteve rrugore dhe rritja e aftesive te nevojshme per te trajtuar sic duhet cdo ceshtje qe del nga auditimet.

Informacion mbi Klientin

Klient per Projektin eshte Qeveria e Kosoves e perfaqesuar nga Ministria e Financave. Kredia do te jepet per t'u perdorur nga Ministria e Infrastruktures (MI) e cila ka pergjegjesine per organizimin dhe drejtimin e sektorit te transportit ne Kosove. Brenda MI, Departamenti i Infrastruktures Rrugore (DIR) eshte pergjegjes per zhvillimin e strategjise rrugore, menaxhimin e buxheteve dhe pergatitjen e kontratave per mirembajtjen dhe zhvillimin e rrugeve.

Permbledhje e Financimit te BERZH

Nje kredi sovrane per Kosoven per te bashkefinansuar punimet e ndertimit qe lidhen me Projektin.

Kostoja e Pergjithsme e Projektit

Kostoja e pergjithsme e Projektit llogaritet te jete perafersisht 113.4 milione Euro.

Permbledhje Mjedisore dhe Sociale

Kategoria mjedisore A (ESP 2014). Ndertimi i seksionit rrugor Kijeve – Zahaq, pjese e rruges Prishtine – Peje (SEETO Route 6b) mund te rezultoje potencialisht me ndikime mjedisore dhe sociale te medha negative dhe kerkon nje Vleresim te Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe nje process konsultimi zyrtar me publikun, perfshire dhe nje periudhe minimale 120 ditore per venien ne dispozicion te publikut te dosjes se plote te VNMS. Nje konsulent i pavarur eshte duke kryer nje analize te hollesishme mjedisore dhe sociale e cila perfshin dhe nje Vleresim Paraprak te Ndikimit ne Mjedis (VPNM) te te gjitha alternativave qe jane marre ne konsiderate per Projektin e qe perfshijne ndikimin ne cilesine e ajrit, zhurmat nga trafiku, biodiversitetin, ceshtjet sociale ne kuader te pergatitjes se Studimit te Para-Fizibilitetit.

Pas marrjes se vendimit per perzgjedhjene e alternatives se preferuar, do te pergatitet VNMS ne perputhje me EU EIA Directive 2011/92/EC, kerkesat e Politikes Mjedisore dhe Sociale te BERZH dhe procedurat kombetare te Vleresimit te Ndikimit Mjedisor (VNM) ne Kosove. VNMS do te plotesohet me nje dosje per venien ne dispozicion te publikut qe perfshin Permbledhjen Jo-Teknike gjithepershiresse, Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS), Planin e Angazhimit te Paleve te Interesuara (PAPI) dhe Kuadrin per Shpronosimin e Truallit dhe Zhvendosjen. Klienti do t'i paraqese BERZH raportet vjetore mjedisore dhe sociale. Projekti do te monitorohet nga BERZH ne perputhje me angazhimet e PVMS, kerkesat rregullatore dhe Kerkesat e Performances te BERZH. BERZH gjithashtu mund te kryeje vizita monitoruese. DPP do te perditesohet pas perfundimit dhe publikimit te VNMS.

Bashkepunimi Teknik

Projekti do te perfshije edhe programe te bashkepunimit teknik si me poshte:

1. Perditesimi i Studimit te Fizibilitetit dhe projektit teknik te detajuar;
2. Inxhinier per supervizionimin e punimeve;

3. Forcimi i kapaciteteve institucionale per krijimin e Agjencise se Rrugeve;
4. Pergatitja e strategjise per mirembajtjen e rrugeve.

Informacion Kontakti i Klientit

z. Rame Qupeva, Drejtor

rame.qupeva@rks-gov.net

+381 38 211494

www.mi-ks.net

Departamenti i Infrastruktures Rrugore, Ministria e Infrastruktures,
Ndertesa Germia, Rruga Nene Tereza,
Prishtine, Kosove

Mundesi biznesi

Per mundesi biznesi ose prokurimi, kontaktoni Klientin.

Pyetje te pergjithshme

Pyetje të përgjithshme për projekte të BERZH që nuk lidhen me prokurimin:

Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika per Informimin e Publikut (PIP)

PIP përcakton se si BERZH jep informacione dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyre që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj.

Teksti i PIP mund të gjendet në:

<http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm>

Mekanizmi i Ankesave i Projektit (MAP)

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankesave të Projektit (MAP) për të siguruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata në lidhje me projekte të financuar nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose mund të shkaktojnë efekte negative. Rregullat e procedurës së MAP mund të gjenden në:

<http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Çdo ankese në bazë të MAP duhet të paraqitet jo më shumë se 12 muaj pas shpërndarjes së fundit të fondeve të BERZH-it. Ju mund të kontaktoni zyrtarin e MAP në adresën (pcm@ebrd.com) ose Zyren përkatëse të Përfaqësuesit të BERZH për ndihmë nëse nuk jeni të sigurt për ankesën tuaj.